

L I G J
Nr.9459, datë 21.12.2005

**PËR DISA NDRYSHIME DHE NJË SHITESË NË LIGJIN NR.8701, DATË 1.12.2000 "PËR
LOJËRAT E FATIT, KAZINOTË DHE HIPODROMET", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8701, datë 1.12.2000 "Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 10 "Detyrimet tatimore", në pikën 4 bëhen këto ndryshime:

1. Paragrafi "i" i shkronjës "a" ndryshohet si më poshtë:

"i) organizatori i lojës bingo që zhvillohet për pjesëmarrës brenda sallës, paguan një tatim për lojërat e fatit me një kuotë fikse, çdo muaj, për çdo sallë, përkatësisht 500 000 lekë për rrethet e kategorisë së parë, 400 000 lekë për rrethet e kategorisë së dytë dhe 300 000 lekë për rrethet e kategorisë së tretë;"

2. Paragrafi "ii" i shkronjës "b" ndryshohet si më poshtë:

"ii) organizatori i basteve sportive paguan tatim mbi lojërat e fatit me kuotë fikse, si më poshtë:

- 1 000 000 lekë çdo muaj për shoqërinë;
- 40 000 lekë për çdo pikë shitjeje të basteve, për rrethet e kategorisë së parë;
- 30 000 lekë për çdo pikë shitjeje të basteve, për rrethet e kategorisë së dytë;
- 20 000 lekë për çdo pikë shitjeje të basteve, për rrethet e kategorisë së tretë;"

3. Paragrafët "i", "ii" dhe "iii" të shkronjës "c" ndryshohen si më poshtë:

"i) për rrethet e kategorisë së parë, 30 000 lekë në muaj, për çdo kompjuter elektronik, si edhe 40 000 lekë në muaj, për çdo pozicion loje të makinës elektronike;

ii) për rrethet e kategorisë së dytë, 20 000 lekë në muaj për çdo kompjuter elektronik, si edhe 30 000 lekë në muaj për çdo pozicion loje të makinës elektronike;

iii) për rrethet e kategorisë së tretë, 14 000 lekë në muaj për çdo kompjuter elektronik, si dhe 20 000 lekë në muaj për çdo pozicion loje të makinës elektronike;"

Neni 2

Në nenin 22 "Detyrimi tatimor për kazinotë", në pikën 4 shkronjat "a", "b" dhe "c" ndryshohen si më poshtë:

"a) për çdo tavolinë të lojës së fatit ruletë, një taksë mujore në masën 800 000 lekë;

b) për çdo tavolinë të lojërave me letra dhe me zare, një taksë mujore në masën 600 000 lekë;

c) për lojërat elektronike dhe sllot makinat me fitim në çast, të vendosura në mjediset e kazinosë, një taksë mujore 60 000 lekë për çdo kompjuter elektronik. Për makinat elektronike me më shumë se një pozicion, një taksë mujore 80 000 lekë në muaj për çdo pozicion;"

Neni 3

Në nenin 25 "Detyrimi tatimor për hipodromet", në pikën 4 shkronjat "a", "b" dhe "c" ndryshohen si më poshtë:

"a) një tatim loje fati me kuotë fikse, çdo muaj, prej 2 000 000 lekësh për shoqërinë;

b) një tatim loje fati me kuotë fikse, çdo muaj, prej 40 000 lekësh për çdo pikë të shitjes së basteve;

c) për lojërat elektronike me fitim në çast, të vendosura në mjediset e hipodromit, një tatim me kuotë fikse, çdo muaj, prej 40 000 lekësh për çdo kompjuter elektronik ose pozicion të makinës elektronike;"".

Neni 4

Pas nenit 27 shtohet neni 27/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 27/1

Sanksionet në fushën e tatimeve

1. Mosdeklarimi dhe mospagesa e një shume detyrimi tatimor, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë në masën 50 për qind të shumës së detyrueshme për t'u paguar.

2. Pagesa e vonuar e detyrimit tatimor për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë në masën 10 për qind të shumës së paguar jashtë afatit.

3. Për mospagimin në afat të detyrimeve tatimore, përveç dënimeve të mësipërme, kundërvajtësi paguan edhe interesat për pagesën e vonuar, në përputhje me ligjin nr.8560, datë 22.12.1999 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.”.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4737, datë 28.12.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Alfred Moisiu